



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 10.3.2025

Nr: 18

Ora: 14:30

VENDIM  
PËR

**PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE  
PËR SHFAQJEN E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDET E NUMËRIMIT  
TË VOTAVE NGA JASHTË DHE BRENDË VENDIT, NË ZGJEDHJET  
PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 399, datë 05.12.2024, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvend", nenit 20, pika 2, shkronja "c", nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 25/2, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në çdo vend të numërimit të votave nga jashtë dhe brenda vendit, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga jashtë dhe brenda vendit nga çdo vend i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve), dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga çdo vend i numërimit të votave nga jashtë dhe brenda vendit, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ nga Komisioni Rregullator.
4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO** Kryetar  
**Arens ÇELA** Anëtar  
**Dritan ÇAKA** Anëtar  
**Helga VUKAJ** Anëtar  
**Muharrem ÇAKAJ** Anëtar

Data: 10.3.2025 Nr: 18  
Ora: 14:30



"Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave nga jashtë dhe brenda vendit, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025"